



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Stafin administrative të gjykatave dhe prokurorive
- * Aktivitetet tjera

Mars 2018

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Abuzimi seksual dhe shfrytëzimi i fëmijëve

Më 27 shkurt – 2 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Prishtinë, ka realizuar trajnimin me temë “Abuzimi seksual dhe shfrytëzimi i fëmijëve”.



Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve për të mitur, në zbatimin e drejtë të hetimit, mbledhjes së provave si dhe në gjykimin e kryesve të këtyre veprave penale që kanë të bëjnë me fëmijët si viktima të abuzimit seksual. Në kuadër të këtij trajnimi u trajtua hetimi i abuzimit fizik dhe seksual të fëmijëve, grumbullimi i provave, nevoja e hartimit dhe përdorimit të protokollit për intervistimin e

fëmijëve viktima apo dëshmitarë. Paraprakisht vëmendje parësore iu kushtua përgatitjes së viktimave fëmijë për gjykim, metodave teknike dhe taktike të marrjes në pyetje të viktimitës si dhe të dyshuarit.

Njëkohësisht, u analizuan teknologjia dhe zgjidhja e rasteve si dhe hetimi i pornografisë së fëmijëve duke përfshirë edhe elaborimin e legjislacionit vendor atë material dhe procedural që e rregullojnë këtë fushë mjaftë të ndjeshme për shoqërinë në tërësi.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të trajnimit ishin prokurorë nga Prokuroria e Apelit, gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelore të departamentit për të mitur si dhe zyrtar nga Qendra për Punë Sociale, mbrojtës të viktimave, dhe zyrtar nga policia e Kosovës.



Ligji për Shoqëritë Tregtare

Më 01 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoj trajnimin me temë “Ligji për Shoqëritë Tregtare”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shoqëritë tregtare, strukturën rolin dhe rëndësinë e tyre në Republikën e Kosovës.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan mënyrat e organizimit, struktura e kapitalit, të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë. Ndërsa në pjesën e dytë u vazhdua me trajtimin procedurave ligjore dhe aplikimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga shoqëritë tregtare.

Në vazhdim u trajtuan çështjet e ekspertizës profesionale të gjyqtarëve në këtë lëmi, si të realizohet praktika gjyqësore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, u paraqiten përvojat dhe praktikat më të mira të shteteve në rajon dhe format e aplikimit në mënyrë efikase të instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë. Në fokus të trajnimit ishte edhe analizimi i koncepteve kryesore dhe parimeve të shoqërive tregtare (SHT), problemeve me praktikën e kaluara dhe atyre aktuale të ushtrimit të afarizmit në Kosovë, zhvillimi i shoqërive tregtare në Evropë, zgjidhja gjyqësore e kontesteve të aksionarëve dhe strukturave udhëheqëse të korporatave dhe bazave tatimore në Kosovë për shoqëritë

tregtare.

Në trajnim u veçua se Ligji për Shoqëritë Tregtare, parasheh udhëzime për një shoqëri që dëshiron të ushtrojë afarizëm në Kosovë, promovon një kornizë ligjore për investitorët e huaj të cilët synojnë të hyjnë në tregun e Kosovës, ashtu edhe për afaristët vendorë të cilët aspirojnë rritjen dhe zgjerimin e biznesit të tyre, është i bazuar në modelin austro-gjerman, ofron disa forma themelore të organizimit të biznesit me të cilat investitorët e huaj janë të familjarizuar, por me kalimin e kohës, do të jetë e nevojshme që edhe ky ligj të ndryshohet dhe plotësohet në mënyrë që t'i përshtatet nivelit të përsosjes së komunitetit afarist dhe atij juridik në Kosovë.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit debatuan lidhur me llojet e shoqërive tregtare përmes të cilave mund të zhvillohen veprimtaritë afariste, kushtet e regjistrimit, strukturën juridike të shoqërive tregtare si dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve/aksionarëve, menaxherëve, drejtorëve, përfaqësuesve juridik dhe palëve të treta, dispozitat ligjore të cilat lehtësojnë themelimin, funksionimin dhe shpërbërjen e rregullt të SHT, inkurajimin e ndërmarrësisë përmes kufizimit të detyrimeve të investitorëve dhe tërheqjen e kapitalit të huaj.

Në trajnim u përdoren metoda si shpjegime të pjesshme teorike, shembuj të rasteve konkrete, diskutime dhe detyra të përpiluara për aplikimin e koncepteve të strukturave afariste në situata praktike mbi parimet dhe rregullat kryesore lidhur me shoqëritë tregtare.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit si dhe gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore –divizionet civile si dhe bashkëpunëtorët profesional.

Procedura gjyqësore në bazë të kompetencave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Më 06 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Procedura gjyqësore në bazë të kompetencave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Agjencisë Kosovare të Privatizimit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me procedurat gjyqësore që zhvillohen në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore mbi kompetencën e kësaj Dhome si dhe rolin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në trajnim dominuan temat lidhur me: kompetencën funksionale me fokus në Dhomën e Posaçme, parashtruesit dhe palët kundërshtarë në Dhomën e Posaçme dhe fushëveprimi i kompetencave administrative të AKP-së. Po ashtu u trajtua edhe transformimi i ndërmarrjeve në një apo më tepër korporata dhe shitja e aksioneve. Mandati i AKP-së përfshinë çdo veprim që agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur, brenda kufijve të burimeve administrative të Agjencisë, për të mundur mirë shitjen, likuidimin, transferimin apo ndonjë zgjidhje tjetër të ndërmarrjes, asetit apo

interesit në pronësi shtetërore.

Po ashtu u potencua se neni 4 i Ligjit për DHPGJS në fuqi, është ai që përcakton juridiksionin ekskluziv të Dhomës së Posaçme. Sipas kësaj dispozite DHP ka kompetencë të vendosë mbi të gjitha rastet dhe procedurat në lidhje me kundërshtimet ndaj një vendimi apo veprimi të AKM-së, tani AKP-së, apo kërkesat e palëve që pretendojnë ndonjë të drejtë, titull apo interes me të cilën administron AKP. Çështja e kompetencës mori një vëmendje të posaçme gjatë diskutimit, megjëse në kohët e fundit ka pasur disa raste kur gjykata themelore ka kthyer lëndët në Dhomën e Posaçme, edhe pse kjo Dhomë më parë kishte lëshuar vendimin e saj rreth mungesës së juridiksionit.

Këto dhe dilema tjera të ngritura nga pjesëmarrësit u trajtuan në thellësinë e tyre përmes debatit interaktiv, pyetjeve të pjesëmarrësve dhe shpjegimeve dhe përgjigjeve të trajnuesve duke nxjerr përfundime të bazuara ligjore.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, gjyqtarët e gjykatave themelore-divizionit civil dhe zyrtarët e AKP-së.



Palët në procedurë, bashkë-ndërgjyqësit dhe ndërhyrësit në procedurë

Më 13 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë “Palët në procedurë, bashkë-ndërgjyqësit dhe ndërhyrësit në procedurë”.

Qëllimi i këtij trajnim ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve të lëmisë civile për palët, bashkë-ndërgjyqësit dhe ndërhyrësit në procedurë.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtua zotësia procedurale e palës, dhe bashkë-ndërgjyqësit dhe llojet e tyre. Në fokus ishte nocioni i bashkë-ndërgjyqësisë, llojet e bashkë-ndërgjyqësisë, efektet e vendimeve të bashkë-ndërgjyqësve në procedurën kontestimore, pozita procedurale, veprimet e tyre, dhe pasojat të cilat i shkaktajnë ato veprime.

Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan efektet e veprimeve procedurale të bashkë-ndërgjyqësve dhe pjesëmarrja e personave të tretë në kontest civil. Në këtë kontekst u zbërthye roli i ndërhyrësit; mënyrat e ndërhyrjes dhe llojet e ndërhyrësve dhe efekti i aktgjykimit ndaj bashkë-ndërgjyqësve dhe ndaj ndërhyrësve, si dhe kushtet që parasheh LPK për lejimin e ndërhyrjes.

U ritheksua se çështja e bashkë-ndërgjyqësisë

dhe personave të tretë në procedurë, në praktikën gjyqësore paraqet një fenomen procedural mjaft kompleks i cili krijon dilema për gjyqtarët të cilët i zhvillojnë procedurat kontestimore të cilat u ngritën edhe në këtë trajnim, por që u evituan përmes shpjegimeve të trajnuesve dhe bashkëbisedimit interaktiv me pjesëmarrësit.

Ky trajnim ofroj përgjigje në pyetjet që u ndërlidhën për bashkë-ndërgjyqësinë, llojet e saj, efektet që krijon ajo në procedurën kontestimore, mënyrën e vendosjes për secilën formë të bashkëndërgjyqësisë dhe pjesëmarrjen e personave të tretë në procedurën kontestimore. Gjithashtu u trajtuan edhe llojet e ndërhyrësve, kushtet që parasheh LPK për lejimin e ndërhyrjes si dhe dallimi mes ndërhyrësve.

Në trajnim u përdoren metoda të shpjegimit teorik dhe praktik të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore, e që dilemat e ngritura u trajtuan në thellësinë e tyre edhe përmes shpjegimeve të trajnuesve.

Përfitues ishin gjyqtarë të nivelit themelor, të divizioneve civile të departamenteve të përgjithshme si dhe bashkëpunëtor profesional.



E drejta e BE-së në funksion të zbatimit të MSA-së

Më 15 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, me mbështetje të UNDP-së realizoi trajnimin me temë “E drejta e BE-së në funksion të zbatimit të MSA-së”.

Ky trajnim kishte për qëllim të avancoj njohuritë e gjyqtarëve dhe prokurorëve mbi efektin e të drejtës së Bashkimit Evropian në nivel nacional dhe analizimin e aspekteve të zbatimit të kësaj të drejte para anëtarësimit në BE veçmas pas hyrjes në fuqi të MSA-së.

Në fillim u trajtua zbatimi gjyqësor i Marrëveshja për Stabilizim – Asocimin (MSA) në Republikën e Kosovës dhe ndikimin e saj në legjislacionin e brendshëm gjatë zbatimit të MSA-së. Ndërsa në vazhdim u trajtua mbrojtja gjyqësore e së drejtës kundër diskriminimit me vështrim të veçantë në KEDNJ dhe të drejtën e BE-së.

Në trajnim dominoj tematika lidhur me efektin e së drejtës evropiane pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim–Asocim, vështirësitë dhe dilemat që lidhen me

interpretimin e efektit të saj në nivel nacional. U potencua se Marrëveshja për Stabilizim dhe Asocim gëzon efekt direkt pas ratifikimit të Ligjit Nr. 05/L-069 për ratifikim të MSA-së ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike. Sipas MSA-së në mënyrë të qartë përcaktohet obligimi për përafrimin e legjislacionit të Kosovës me *acquis communautaire*.

Po ashtu fokusi u përqendrua në zbërthimin e efektit të së drejtës së BE-së pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim dhe zbatimi i parimeve të kësaj të drejte si (ai i epërsisë, efektit të drejtpërdrejt dhe të tërthortë) që lidhen me MSA-në dhe ndikimin e saj në gjyqësorin e Kosovës.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës



Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftë kundër Korrupsionit Sesi I

Më 15-16 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e parë të trajnimit me temë “Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë që të kuptojnë natyrën dhe format e korrupsionit si dhe veprat penale që janë të ndërlidhura me korrupsion.

Ky sesion trajnimi trajtoj veprat penale korruptive, kuptimin e korrupsionit sipas legjislacionit penal në fuqi, pasojat e

korripsionit si dhe format e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit.

Gjithashtu gjatë trajnimit u elaboruan instrumentet vendore dhe ndërkombëtare në luftë kundër korrupsionit, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës korruptive si dhe masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtarë.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës si dhe bashkëpunëtor profesional.



Mbrojtja efektive në procedurë penale dhe garantimi i barazisë së palëve-caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike

Më 20 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me GIZ, ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja efektive në procedurë penale dhe garantimi i barazisë së palëve-caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike”.



Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore kur kemi të bëjmë me mbrojtjen efektive në procedurë penale dhe garantimi i barazisë së palëve-caktimi i mbrojtësit me shpenzime publike.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan dispozitat ligjore të KPPK si dhe praktikat më të mira në përmbushjen e kërkesave ligjore për të ofruar mbrojtje efektive të të pandehurve në procedurën penale.

Vëmendje iu kushtua edhe pasojave procedurale në rastet e mos njoftimit të të pandehurve për mundësinë e caktimit të avokatit mbrojtës edhe kur mbrojtja nuk është e detyruar si dhe rastet kur për shkak të pamundësisë financiare, KPPK ka paraparë caktimin dhe angazhimin e mbrojtësit me shpenzimet publike për situatat kur mbrojtja nuk është e detyrueshme, me kërkesë të të pandehurit nën kushtet e parapara ligjore, në veçanti kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë, pavarësisht nga dënimi i parashikuar. Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Instrumentet e të drejtës penale ndërkombëtare për ndjekjen penale të krimeve të luftës në kuadër të juridiksionit të Kosovës – Një qasje praktike

Më 21-22 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-in realizoi trajnimin me temë “Instrumentet e të drejtës penale ndërkombëtare për ndjekjen penale të krimeve të luftës në kuadër të juridiksionit të Kosovës – Një qasje praktike”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve që të kuptojnë instrumentet e disponueshme ligjore ndërkombëtare dhe vendore, që kanë të bëjnë me hetimin dhe gjykimin e veprave penale të ndryshme që kanë të bëjnë me krimet e luftës.

Në fokus të trajnimit ishin veglat praktike për kërkim të cilat janë të aplikueshme në jurisprudencën e të drejtës penale ndërkombëtare duke u ndërlidhur me praktikën gjyqësore të vendimeve gjyqësore të Tribunaleve Ndërkombëtare.

Vëmendje parësore iu kushtua nocionit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, të bashkëkryerjes, ndihmës, urdhrave, duke përfshirë përgjegjësinë komanduese në të drejtën penale ndërkombëtare. Po ashtu u trajtua baza ligjore për aplikimin e teorive dhe praktikës së të drejtës penale ndërkombëtare në kuadër të juridiksionit të Kosovës kur kemi të bëjmë me krimet e luftës të cilat kanë ndodh në Kosovë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, prokurorë nga Prokuroria Speciale, gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Zbatimi praktik i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Më 22 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin me temë: “Zbatimi praktik i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve rreth të drejtave, përgjegjësisë, parimet dhe masat për mbrojtjen e të dhënave personale si dhe për zbatimin e drejtë të dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan baza ligjore e përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale dhe mbrojtja e tyre institucionale. Ndërsa në pjesën e dytë u vazhdua me trajtimin e të drejtave dhe përgjegjësisë të kontrolluesve të të dhënave.

Në kontekst të tematikës së përmendur u zbërthe mandati ligjor dhe përgjegjësitë e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përpunimi i të dhënave personale, parimet e përpunimit si dhe masat dhe procedura në rastin e shkeljes së këtyre të dhënave. U prezantuan edhe përvojat dhe praktikatat e mira të shteteve në rajon si dhe format e aplikimit në mënyrë efikase të

instrumenteve ndërkombëtare që rregullojnë këtë sferë. Në fokus të trajnimit ishin edhe çështjet si zbërthehet dhe bëhet përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale si dhe si mbrohen këto të dhëna.

Në trajnim u veçua përfundimi se mbrojtja e të dhënave personale në Republikën e Kosovës, është një e drejtë themelore që garantohet me Kushtetutë, e cila në nenin 36 specifikon se privatësia dhe jeta familjare, paprekshmëria e vendbanimit, fshehtësia e korrespondencës, komunikimi me telefon dhe mjetet tjera, dhe mbrojtja e të dhënave personale janë të garantuara për secilin individ. Gjithashtu, kjo Kushtetutë garanton zbatimin e Konventave ndërkombëtare dhe evropiane, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, siç janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe protokollat shtesë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, të Gjykatës së Apelit si dhe zyrtarë të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



Qasja në dokumente publike dhe mbrojtja e privatësisë në media-Liria e Shprehjes dhe e medias

Më 27-28 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me projektin “Përforcimi i ekspertizës gjyqësore mbi lirinë e shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore – JUFREX”, organizoj trajnimin me temë: “Qasja në dokumente publike dhe mbrojtja e privatësisë në media – Liria e Shprehjes dhe e medias”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me standardet vendore dhe ndërkombëtare në rregullimin e qasjes në dokumente publike dhe mbrojtjen e privatësisë në media.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtua korniza ligjore në Republikën e Kosovës për të drejtën e privatësisë gjatë raportimit në media, pastaj korniza institucionale në rregullimin e privatësisë gjatë raportimit në media, roli i Agjencionit Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe i Institucionit të Avokatit të Popullit. Gjithashtu u shtjelluan standardet e GJEDNJ në mbrojtjen e privatësisë, lirinë e shprehjes, rolin e mediave dhe gazetaria e përgjegjshme, reputacioni si pjesë e të drejtës së privatësisë, balancimi i lirisë së shprehjes dhe privatësisë, mediat dhe e drejta e privatësisë. Në vazhdim u trajtuan çështjet e xhirimeve nga mediat të seancave gjyqësore në gjykatat në Kosovë dhe praktikat më të mira. Në fokus ishte Rregullorja e KGJK-së për xhirimin e seancave

gjyqësore, Vendimi i EULEX-it për xhirimin e seancave dhe shembuj nga praktika e gjykatave në Kosovë.

Ndërsa në ditën e dytë u vazhdua me trajtimin e kornizës ligjore vendore për qasje në dokumente publike, institucionet vendore për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, në këtë kontekst roli i Agjencionit Shtetëror për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Institucioni i Avokatit të Popullit. Gjithanshëm u shtjelluan standardet e GJEDNJ në të drejtën e qasjes në dokumente publike, precedentët gjyqësorë në të drejtën e qasjes në informacione dhe një analizë e katër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore të Prishtinës.

Pjesëmarrësit të ndihmuar nga trajnuesit morën pjesë në diskutimin dhe trajtimin e një rasti, ku ata ofruan zgjidhje lidhur me kërkesat që përmbante rasti e që ishte dedikuar të drejtës për qasje në informacione. Në fund u paraqiten disa shpjegime me vlerë nga këndvështrimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me tematiken e përmendur.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe prokurorët të nivelit themelor si dhe bashkëpunëtorë profesional.



Dënimet alternative dhe plotësuese

Më 29 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ ka organizuar trajnimin me temën “Dënimet alternative dhe plotësuese”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve me infrastrukturën ligjore me rastin e shqiptimit të dënimeve alternative dhe plotësuese si dhe procedurën për shqiptimin e tyre.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua dënimi me kusht, gjysmë liria, urdhri për punë në dobi të përgjithshme, heqja e të drejtës për tu zgjedhur, urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit, ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik si dhe ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës.

Vëmendje iu kushtua edhe hartimit të aktgjykimeve për shqiptimin e dënimeve alternative dhe plotësuese dhe rolit të Shërbimit Sprovues në risocializimin dhe ri integrimin e personave të dënuar me dënime alternative.

Gjithashtu u trajtuan rastet nga praktika gjyqësore, si dhe shkëmbimi i përvojave me qëllim të eliminimit të dilemave të cilat shfaqen në praktikë, në rastet kur kemi të bëjmë me shqiptimin e këtyre dënimeve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë të nivelit themelor si dhe zyrtarë nga Shërbimi Sprovues.



Komunikimi me Media për Prokurorët dhe Zyrtarët e Prokurorisë

Më 29-30 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me EULEX-in, organizoi trajnimin me teme “Komunikimin me Medie për Prokurorë dhe Zyrtarë të Prokurorisë”.



Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të pjesëmarrësve në qasjen e tyre që t'i përcjellin mesazhet tek publiku duke iu përshtatur situatave konkrete.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtua roli i komunikimit gjatë menaxhimit të krizave.

Vëmendje iu kushtua sqarimit se si ndikon komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm kështu që, u theksua se duhet të fuqizohet komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm për komunikim me media, në mënyrë që t'u ofrohen mjetet e nevojshme për t'i ndihmuar mediat që të ballafaqohen me sfidat e punës së përditshme në komunikimin me publikun dhe t'i përcjellin informatat në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Po ashtu, gjatë trajnimit u diskutua veçanërisht praktika suedeze dhe roli i prokurorit suedez si dhe autoriteti i prokurorisë suedeze me theks të veçantë departamenti i komunikimit sfidat në komunikimin me medie.

Përfitues të këtij trajnimi ishin prokurorë nga prokuroritë themelore, përfaqësues të mediave, administrator dhe zëdhënës nga prokuroritë themelore, zyrtarë nga Prokuroria e Shtetit, dhe zyrtar të EULEX-it.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara për gjyqtarët në PTF

Akademia e Drejtësisë, gjatë muajit mars, ka realizuar aktivitetet në kuadër të PTF-së, për gjyqtarët e sapoemëruar, ashtu siç ishin planifikuar me programin trajnues.



Komponenta e trajnimit teorik, për këtë periudhë, është përbushur duke realizuar aktivitetet nga nën modulet si në vijim: “E drejta civile” është realizuar një (1) sesion trajnues, “Procedura kontestimore pjesa e parë” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese, “Procedura kontestimore pjesa e dytë” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese dhe “Procedura Përmbarimore” janë realizuar (2) sesione trajnuese.

Në kuadër të nën-modulit “Procedura kontestimore pjesa e parë” janë trajtuar: afatet dhe kthimi në gjendjen e mëparshme, përfundimi i procedurës me vendim të gjykatës, llojet e aktgjyqimeve sipas LPK-së, mjetet e rregullta të goditjes dhe të jashtëzakonshme të goditjes.

Nga nën moduli “Procedura kontestimore pjesa e dytë, është shqyrtuar paraqitja e padisë në gjykatën e shkallës së parë, shqyrtimi paraprak i padisë dhe përgjigja në padi, përgatitja e seancës për shqyrtim kryesor dhe seanca për shqyrtim kryesor, mjetet provuese dhe marrja e provës dhe sigurimi i kërkesëpadisë.

Nga procedurën përmbarimore është trajtuar propozimi përmbarimor dhe vendimet e organit përmbarues lidhur me lejimin, pezullimin dhe përfundimin e procedurës dhe titujt ekzekutiv si dhe përmbarimi përmes xhirollogarive bankare. Ndërsa nga nën moduli “E drejta civile” në këtë periudhë sipas programit trajnues është realizuar një sesion trajnimi ku janë trajtuar veprimet e palejueshme (deliktet), pasurimi i pabazë dhe mbrojtja e të drejtave.

Pjesë e aktivitetëve të realizuara në këtë periudhë, ishin edhe vizitat e realizuara në institucionet jo-gjyqësore. Në këtë kuadër, janë realizuar dy (2) të tilla, duke vizituar Burgun e Sigurisë së Lartë dhe Agjencionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ndërsa në kuadër të trajnimit praktik, gjyqtarët e sapo emëruar kanë vazhduar praktikën në gjykatat përkatëse konform orarit të përcaktuar me program.



Takimi me mentorët e trajnimit fillestar

Më 05 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të përgatitjeve finale për fillimin e Programit të Trajnimit Fillestar, ka realizuar takimin me mentorët e angazhuar në trajnimin fillestar për prokurorët e sapoemëruar - gjenerata e shtatë.

Takimi kishte karakter njoftues, në mënyrë që mentorët të njoftohen me rolin dhe përgjegjësitë e tyre në procesin e mentorimit të prokurorëve të sapoemëruar si dhe programin trajnues që do të zbatohet gjatë periudhës 12 mujore.

Në kuadër të këtij takimi, fillimisht u prezantua struktura e Programit të Trajnimit Fillestar, me theks në pjesën praktike të tij, rregullat dhe

standardet që përcakton Doracaku për Mentor, si dhe mënyra e organizimit dhe zbatimit të këtij procesi. Po ashtu u diskutua çështja e vlerësimit të prokurorëve të sapoemëruar nga ana e mentorëve të tyre, si dhe çështje tjera organizative që ndërlidhen me realizimin e trajnimit praktike të PTF-së.

Mentorët janë pajisur me dokumente që hynë në kuadër të PTF-së, siç janë: Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar, Programi i Trajnimit Fillestar si dhe Doracaku për Mentor.



Fillimi i Programit të Trajnimit Fillestar për prokurorët e sapoemëruar – gjenerata e shtatë

Më 05 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, pas dekretimit të prokurorëve të shtetit, dhe kërkesës së KPK-së, ka filluar zbatimin e Programit të Trajnimit Fillestar, duke realizuar në këtë formë takimin e parë me prokurorët e sapoemëruar.

Në fjalën hyrëse Drejtori i Akademisë së Drejtësisë, z. Valon Kurtaj, fillimisht i uroj prokurorët e ri për emërimin e tyre, dhe i njoftojë ata me rolin dhe rëndësinë që ka trajnimi fillestar, për përgatitjen e tyre të mëtejme profesionale. Prokurorët e sapoemëruar po ashtu në pika të shkurtra u njoftuan me strukturën e PTF-së, si dhe mënyrën e organizimit dhe realizimit të tij, si të pjesës teorike, po ashtu edhe pjesës praktike.

Ndërsa, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Blerim Isufaj, shprehu mbështetjen e KPK-së në drejtim të prokurorëve të

sapoemëruar, duke i inkurajuar ata për një përkushtim dhe angazhim maksimal gjatë trajnimit fillestar, duke potencuar rëndësinë e këtij trajnimi, në përgatitjen adekuate të tyre që të ushtrjnë në mënyrë të drejtë dhe profesionale funksionin e prokurorit. Gjithashtu z. Isufaj ofroj mbështetje edhe për Akademinë e Drejtësisë, në drejtim të realizimit të suksesshëm të trajnimit fillestar për prokurorët e sapoemëruar.

Prokurorët e sapoemëruar, janë pajisur me dokumente që hynë në kuadër të PTF-së, siç janë: Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar, Programi i Trajnimit Fillestar si dhe Kalendari trajnues për muajin mars 2018.



Aktivitetet e realizuara për prokurorët në PTF

Gjatë muajit mars 2018, në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapoemëruar, janë zhvilluar aktivitetet si në trajnimin teorik po ashtu edhe në trajnimin praktik.

Në këtë periudhë në trajnimin teorik janë realizuar gjithsejtë gjashtë (6) sesione trajnuese nga nën modulet Kodi Penal i Republikës së Kosovës-pjesa e përgjithshme dhe e veçantë. Fillimisht në kuadër të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal të Kosovës u trajtuan elementet e veprës penale, objekti e subjekti i veprës penale, ndarja e tyre, vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale dhe kundërligjshmëria. Ndërsa në kuadër të pjesës së veçantë të Kodit Penal të Kosovës u elaboruan: veprat penale të vrasjes dhe vrasjes së rëndë, veprat penale kundër jetës

dhe trupit dhe lirive e të drejtave të njeriut dhe veprave penale të posedimit të paautorizuar të narkotikëve substancave psikotropike ose analoge.

Përmes detyrave dhe ushtrimeve praktike, prokurorët e sapoemëruar u angazhuan në përgatitjen dhe prezantimin e rasteve për situata të ndryshme hipotetike.

Në kuadër të trajnimit praktikë në prokurori, prokurorët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në prokuroritë përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre.



Trajnim praktik për gjyqtarët e sapo emëruar në Burgun e Sigurisë së Lartë

Më 21 Mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, ka realizuar trajnimin praktik në Burgun e Sigurisë së Lartë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, punën si dhe përgjegjësit që janë të parapara për Burgun e Sigurisë së Lartë.

Në kuadër të kësaj vizite, Drejtori i Burgut prezantoi një historik të shkurtër të themelimit, strukturën e organizimit dhe funksionimit të tij, pastaj theksoi edhe aktivitetet e ndryshme të cilat i kanë në dispozicion të dënuarit, duke filluar nga fushat sportive, sallat e rekreacionit, salla e fitnesit si dhe sallat e leximit -

bibliotekën. Gjatë elaborimit rreth të dënueve Drejtori potencoi se në Burgun e Sigurisë së Lartë janë duke e vuajtur dënimin kryesisht të denuar për vepra të rënda penale si: vrasje, krimi i organizuar, krimet e luftës, terrorizëm etj, pra vepra të rënda penale me mbi 15 vite dënim.

Gjyqtarët e sapo emëruar u ndan në dy grupe me stafin e qendrës ku vizituan ambientet e institucionit, kushtet dhe aktivitetet që i ofron ky institucion.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Trajnim praktikë për gjyqtarët e sapo emëruar në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Më 27 Mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, ka realizuar trajnimin praktik në Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte, që gjyqtarët e sapo emëruar të njoftohen për parimet, detyrat, funksionimin dhe rolin e ASHMDHP-së, si dhe përgjegjësitë ligjore në raport me mbrojtjen e të dhënave personale.

Në kuadër të këtij trajnimi, së pari Drejtori i Përgjithshëm i ASHMDHP-së, prezantoi një historik të shkurtër të themelimit, strukturën e organizimit dhe funksionimit të tij, ku theksoi se puna e përditshme e Agjencisë lidhet drejtpërdrejt me çështjen e mbrojtjes së të dhënave personale dhe qasjes në dokumente publike.

Në kuadër të këtij trajnimi u bisedua për mbrojtjen e të dhënave personale, incizimet e personave në mënyrë të pa autorizuar, mbrojtjen e të dhënave në procedurat e ndjeshme gjyqësore, konfidencialitetin në rastet kur rrezikohet siguria shtetërore etj. Gjithashtu u potencua edhe përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale, ku këto të dhëna mund të përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij ose saj, pastaj përpunimi i të dhënave personale të ndjeshme, mbrojtja e të dhënave personale të ndjeshme, përpunimi për qëllime të kërkimeve historike, statistikore, shkencore si dhe mbrojtja e të dhënave personale të personave të vdekur, siç parashihet me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç'rast gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të bëjnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Trajnim i mentorëve në Programin për Trajnim Fillestar

Më 27 mars 2018, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me projektin e Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme reformës për arsimim ligjor”, dhe Programin për Fuqizimin e Sistemit të Drejtësisë (JSSP) ka realizuar trajnim për gjyqtarët e fushës civile, të cilët janë zgjedhur mentorë për gjyqtarët e sapoemëruar.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që mentorët të ngritin njohuritë e tyre për programin e mentorimit, metodat dhe teknikat e mentorimit, rolin dhe detyrat e tyre si mentorë, si dhe format adekuate të qasjes së tyre në raport me gjyqtarët e sapoemëruar.

Në kuadër të këtij trajnimi së pari, u prezantua struktura e Programit të Trajnimit Fillestar, me theks në pjesën praktike të tij, rregullat dhe standardet që përcakton Doracaku për Mentor, mënyra e organizimit dhe zbatimit të këtij procesi, si dhe roli dhe detyrat e mentorëve në raport me gjyqtarët e sapoemëruar dhe Akademinë e Drejtësisë.

Në fokus të këtij trajnimi, më në detaje u elaborua komponenta e mentorimit si proces, detyrat dhe përgjegjësitë e mentorëve në asistimin e gjyqtarëve të sapoemëruar, mbi mënyrat dhe praktikën më të mira se si të bartin njohuritë profesionale dhe përvojat e tyre praktike tek gjyqtarët nën mentorimin e tyre. Gjithashtu, në kuadër të këtij trajnimi u shtjelluan parimet themelore për menaxhimin e rrjedhës së rasteve, dhe u prezantuan praktikën më të mira të menaxhimit të lëndëve me qëllim që ato të barten tek gjyqtarët e sapoemëruar.

Mentorët janë njoftuar me të gjitha informatat dhe janë pajisur me dokumentet e nevojshme që janë pjesë e Programit për Trajnim Fillestar, siç janë: Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar, Programi i Trajnimit Fillestar, Doracaku për Mentor, etj.



Aktivitetet për stafin administrativ të gjykatave dhe prokurorive

Komunikimi në rastet e krizave

Më 14 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit “Fuqizimi i formulimit të politikave dhe hartimit të legjislacionit - Drejtësia dhe Marrëdhëniet me Publikun” i financuar nga BE, realizoi trajnimin “Komunikimi në rastet e krizave”.

Qëllimi i trajnimit ishte ngritja dhe avancimi i shkathtësive personale të komunikimit tek pjesëmarrësit, si dhe zgjerimi i kapaciteteve profesionale rreth përcjelljes së mesazheve të tyre tek publiku duke iu përshtatur situatave konkrete.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtua roli i komunikimit në Ministrinë e Drejtësisë si dhe të institucioneve tjera siç janë KGJK-ja, KPK-ja, gjykatat dhe prokuroritë. Vëmendje iu kushtua

sqarimit se si ndikojnë politikat qeveritare dhe gjyqësori tek qytetarët gjatë paraqitjes së informacionit. Gjatë u trajnimit u potencua se duhet të fuqizohet komunikimi i jashtëm dhe i brendshëm për komunikim me media, në mënyrë që t’u ofrojmë mjetet e nevojshme për t’i ndihmuar ato që të ballafaqohen me sfidat e punës së përditshme në komunikimin me publikun dhe t’i përcjellin informatat në mënyrë të shpejtë dhe efikase.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Zëdhënës nga Këshilli Prokuroral i Kosovës, nga Gjykata e Apelit si dhe zëdhënës nga gjykatat themelore, nga ministria e drejtësisë, zyrtar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore si dhe nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.



Aktivitetet tjera

Zhvillimi i kurikulës, mësimi për të rritur

Më 07 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin e Shtetit – Zyra Tej-oqeanike për Zhvillim të Prokurorisë, Ndihmë dhe Trajnim (OPDAT), Departamenti Amerikan i Drejtësisë-Zyra Ndërkombëtare për Narkotik dhe Zbatim të Ligjit, realizoj



trajnimin për trajnues me temë “Zhvillimi i kurikulës, mësimi për të rritur”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive të trajnuesve rreth prezantimit efektiv gjatë, zhvillimit të materialeve dhe përdorimit të metodologjisë sa më bashkëkohore gjatë trajnimit.

Trajnimi ishte fokusuar tek përcaktimi i strukturës dhe zhvillimi i materialit, procesi paraprak i hartimit, përcaktimi i pjesëmarrësve, përcaktimi i objektivave të trajnimit, mënyra më e mirë e përgatitjes dhe përdorimit të PowerPoint-it, shkathtësitë e prezantimit, dhe udhëzimet për qasjen e prezantimit.

Trajnimi u zhvillua duke përdorur metoda të kombinuara të prezantimit të teorisë me raste hipotetike, debatit interaktiv, pyetjeve të shtruar nga trajnuesit dhe pjesëmarrësit në trajnim.

Ky trajnim u realizua nga ekspert të fushës së trajnimeve gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivele të ndryshme, trajnues të Akademisë së Drejtësisë.



Prezantimi i Planit Strategjik 2018-2023 i Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, 21 mars 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin e binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e arsimit ligjor në Kosovë” i cili është duke u implementuar në Akademinë e Drejtësisë kanë organizuar “Trajnimi dhe arsimimi për të ardhmen”- Prezantim i Planit Strategjik 2018-2023 të Akademisë së Drejtësisë në Kosovë.

Në këtë prezantim morën pjesë përfaqësues nga



Zyra e Bshkimit Evropian në Kosovë, akterët kryesorë të sistemit të drejtësisë në Kosovë: kryesuesi i Këshillit Gjyqësor dhe ai i Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryeprokurorë të Prokurorive, kryetarë të Gjykatave, Drejtorët e Sekretariateve të KPK-së dhe KGJK-së,

anëtarë të Këshillit Drejtues dhe anëtarë të Këshillit Programor të Akademisë së Drejtësisë, përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë, përfaqësues dhe ekspertë nga projekti i Binjakëzimit “Mbështetje e mëtejme e arsimit ligjor në Kosovë”.

Fillimisht z.Valon Kurtaj-Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë dhe z. Klaus Erdmann -Këshilltar Rezident i Projektit prezantuan synimet kryesore dhe përmbajtjen e Planit Strategjik 2018-2023 të Akademisë së Drejtësisë.

Pas kësaj, të gjithë të pranishmit shkëmbyen mendimet e tyre rreth ngritjes së kapacitetve dhe cilësisë së trajnimeve dhe arsimit gjyqësor.

Pjesëmarrësit u zotuan për një vazhdim të bashkëpunimit ndërinstitucional në mes akterëve në mënyrë që Akademia të zbatojë këtë plan strategjik dhe sistemi gjyqësor dhe prokurorial të jenë sa më efikas.



Inaugurimi i sallës së trajnimit me pajisje të reja të TI-së

Më 30 mars 2018, Në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur e inaugurimit të sallës së trajnimeve me pajisje të reja të teknologjisë informativet të dhuruara nga Projekti për Reformën Ligjore dhe Administrative GIZ.

Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të Akademisë së Drejtësisë dhe përfaqësues të Projektit për Reformën Ligjore dhe Administrative në kuadër të GIZ.

z. Valon Kurtaj, Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë shprehu mirënjohjen dhe falënderimin e tij me rastin e pranimit të pajisjeve dhe theksoi se këto pajisje janë shumë funksionale dhe lehtësojnë realizimin e

aktiviteteve trajnuese. Ndërkaq z. Karl Weber, Drejtor i Projektit, shprehu kënaqësinë e tij që GIZ ka pasur mundësinë e bashkëpunimit me Akademinë e Drejtësisë për kontributin e dhënë në furnizimin me pajisje të TI- me qëllim që të mundësohet realizimi i trajnimeve në mënyrë më praktike dhe interaktive.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi GIZ ka financuar blerjet e pajisjeve sië janë: smart-board, laptopë, fotokopje, skaner, printer dhe pajisje tjera.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**